REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 865/23
Datë/Datum 02.11.2023
PRISHTINË - PRISTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Organi Shqyrtues i Prokurimit
Telo Za Razmatranje Nabavke - Procurement Review Body

Rr. "Migjeni" (ish Banka e Ljublanës), Kati V, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës
Tel: +383 (0)38 312 309 - Email: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 865/23

Në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenin 17 paragrafi 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020 e amandamentuar me datën 30.09.2022, pas shqyrtimit të ankesës së OE "Arianit R. Bytyqi", kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe përditësimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore" me numër të prokurimit 214-23-5692-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme, Kryetari i Panelit Shqyrtues, Vedat Poterqoi, me datën: 07/11/2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet si e palejuar, ankesa e OE "Arianit R. Bytyqi" me nr. të protokollit 2023/0865, e datës 03/11/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe përditësimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore", me numër të prokurimit 214-23-5692-2-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Punëve të Brendshme.

Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta është çështje e gjykuar sipas vendimit të OSHP-së me Nr. 679/23, te datës 16.10.2023.

I lejohet, autoritetit kontraktues – Ministria e Punëve të Brendshme, që të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit të sipërcituar, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh

të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Me datë 09.06.2023, Ministria e Punëve të Brendshme ka publikuar B05-Njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Mirëmbajtja dhe përditësimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore", me numër të prokurimit 214-23-5692-2-1-1.

AK ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës, për operatorin ekonomik te rekomanduar "Inter Adria" LLC me datën 18. 10. 2023.

Me datën 23.10.2023 kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të AK të datës 18.10.2023, operatori ekonomik "Arianit Bytyqi". AK me datën 24.10.2023, refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik.

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 03.11.2023 ka pranuar ankesën me Nr protokolli 865/23 nga operatori ekonomik "Arianit Bytyqi", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtja dhe përditësimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore", me numër të prokurimit 214-23-5692-2-1-1, iniciuar nga Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara, për aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtja dhe përditësimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore", me numër të prokurimit 214-23-5692-2-1-1, iniciuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, konstatohet se njoftimi për kontratë është publikuar në sistemin e-prokurimi me datë 09.06.2023. Operatori ekonomik me të dhënat e cekura si më lartë, me datën 03.11.2023, si pale e pakënaqur me vendimin për dhënie të AK-së së datës 18.10.2023, ka parashtruar ankesë në OSHP (Protokoll 865/23).

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas shqyrtimit dhe realizimit të të gjitha provave dhe shkresave të lëndës, konstaton se për këtë procedurë të prokurimit OE "Arianit Bytyqi", ka parashtruar edhe më parë ankesë në OSHP, me numër të protokollit 2023/0679, për të cilin OSHP me datën 16.10.2023, ka marrë vendim me të cilin ankuesin e ka shpallur si të papërgjegjshëm.

Pas vlerësimit dhe administrimit të të gjitha provave përkitazi me këtë procedurë te prokurimit, OSHP konsideron se ankesa e OE ankues e pranuar në OSHP me datën 03.11.2023 është e palejuar sepse e njëjta është çështje e gjykuar "Res Judicata' më parë dhe për të njëjtin tashmë është marrë vendim.

Nga të gjitha sqarimet e cekura si më lartë, OSHP e hedhë si te pa lejuar ankesën e parashtruar me datën 03.11.2023 me nr. protokolli 865/23 nga operatori ekonomik "Arianit Bytyqi", sepse ankesa për

këtë procedurë të prokurimit, konsiderohet çështje e gjykuar sipas paragrafit 2.16 të nenit 105 të Ligjit për Prokurim Publik, ku thuhet: "*Në rastet e përsëritura me pretendimet e njëjta ankimore, kur objekti i kontestit dhe palët janë të njëjta, për raste të cilat janë shqyrtuar më parë, kryetari i panelit shqyrtues duhet të trajtoj si çështje të gjykuar "res judicata*", dhe konfrom nenit 4, 1. 26 te ligjit, OE ankues "Arianit Bytyqi" me emrin tregtar N.T.SH. "Unisoft" konsiderohet si palë pa interes juridik për shkak se me vendimin 679/23, i njëjti është konsideruar si i papërgjegjshëm, prandaj Ankuesi nuk mund të arrijë të dëshmojë se ka statusin e palës së interesuar sipas dispozitës 4, 1.26 të LPP-së.

OSHP, sqaron se me vendimin 679/23, paneli shqyrtues ka kthyer ne rivlerësim aktivitetin e prokurimit, vetëm për të vërtetuar se a është përmbushur kriteri i dosjes së tenderit sa i përket përvojës së menaxherit të kontratës, dhe ka obliguar AK-në që konform nenit 59 dhe 72 të LPP-së, gjatë rivlerësimit ta vërtetoj këtë fakt, ndërkaq sa i përket pretendimeve tjera të OE "Arianit Bytyqi" paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë pretendime të paqëndrueshme duke e konsideruar të njëjtin si OE të papërgjegjshëm sepse nuk ka përmbushur kriteret kualifikuese të paraqitura në DT dhe NJK.

Autoriteti kontraktues – MPB, mund të vazhdoj më tutje me aktivitetin e prokurimit (e përshkruar me sipër) nëse nuk ka ankesë tjetër për këtë aktivitet. Organi Shqyrtues i Prokurimit i vë në dijeni se në çdo aktivitet AK duhet të veproj konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen ato me nenin 1, 6, 7, 27, 28, 59, 60, 65 të LPP.

Duke qenë se OE ankues me rastin e parashtrimit të ankesës ka paguar tarifë, e njëjta konform nenit 31, par 5 të Rregullores së Punës së OSHP-së, i kthehet OE ankues. I njëjti obligohet që kërkesën për kthim të mjeteve ta parashtrojë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve sipas nenit 31 par 6 të rregullores së cituar më lartë.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa. Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtroj padi në Gjykatën Komerciale - Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK- MPB;
- Operatorit Ekonomik;
- Arkivës së OSHP;
- Për publikim në ueb-faqe